

VENDIM
Nr. 22, datë 20.1.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “MET ALBANIA” SHA NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 53/3 prot., datë 17.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘MET Albania’ sh.a. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “MET Albania” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2498 prot., datë 5.12.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
 - Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 282, datë 18.12.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
 - ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 19.12.2024 dhe 20.12.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.12.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
 - Me shkresën nr. 2488/3 prot., datë 23.12.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar.
 - Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2498/4 prot., datë 27.12.2024. Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, është konstatuar se ende ka dokumentacion që nevojitet të sqarohet/plotësohet. Për këtë arsye, ERE i është drejtuar shoqërisë me një e-mail të protokolluar me nr. 53 prot., datë 9.1.2025.
 - Shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 53/1 prot., datë 14.1.2025.
 - Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, dhe “c”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”, dhe për pikën 2.4, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “MET Albania” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
 2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “MET Albania” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti